



RAPORT MONITORIMI
ZBATIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT
TË KOMISIONERIT PËR
TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E
TË DHËNAVE PERSONALE
2023

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje ekzekutive	3
Qasja vlerësuese.....	4
Masat dhe aktivitetet e parashikuara për zbatim për vitin 2023 dhe niveli i realizimit për secilin objektiv.....	4
Konkluzione dhe Rekomandime.....	10

Përmbledhje ekzekutive

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) në ndërgjegjësim të sfidave dhe qasjeve kundër korrupsionit ka hartuar Planin e Integritetit 2022 - 2025, i cili është miratuar me Urdhrin nr.160, datë 28.09.2022 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Integriteti është me rëndësi të jashtëzakonshme për krijimin e institucioneve publike transparente dhe të përgjegjshme dhe ndihmon që qytetarët të binden se ata punojnë për interesin e tyre. Korrupsioni, konflikti i interesit, mungesa e etikës, janë fenomene që favorizojnë përjashtimin, pabarazinë dhe mosbesimin në institucionet publike. Lufta kundrejt këtyre fenomeneve dhe mbi gjitha parandalimi i tyre, është përgjegjësi institucionale e Zyrës së Komisionerit, e çdo punonjësi dhe drejtuesi të saj, në ushtrimin e veprimtarisë së monitorimit dhe mbikëqyrjes së të drejtës për informim dhe mbrojtjen e të dhënave personale, si dy shtyllat kryesore të përgjegjësisë së autoritetit. Në këtë kontekst planet e integritetit jo vetëm forcojnë institucionin për të parandaluar korrupsionin, por njëherazi kontribuojnë në përfundimin e një kulture të menaxhimit publik me etikë dhe integritet.

Plani i Integritetit 2022 – 2025, i miratuar synon përmirësime dhe përditësime në fushat dhe drejtimet e veprimtarisë së Zyrës së Komisionerit, si:

Objektivi I: Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe forcimi i kapaciteteve njerëzore në lidhje me etikën dhe integritetin.

Objektivi II: Rritja e transparencës dhe mbrojtja e të dhënave personale.

Objektivi III: Përmirësimi i sistemit të ruajtjes së dokumentacionit dhe digjitalizimi i arkivës.

Zyra e Komisionerit është e vetëdijshme se ky dokument është një ndër instrumentet kryesore që demonstroi vullnetin dhe angazhimin për të ngritur nivelin e integritetit institucional.

Zyra e Komisionerit është e ndërgjegjshme se një dokument i tillë kërkon angazhimin serioz, vullnetin e mirë, ndjekjen në vijimësi, ndërveprimin e mirë mes punonjësve të pozicioneve të ndryshme, të atyre të shërbimit civil dhe të jashtëm, e të çdo pozicioni pune, me qëllim arritjen me sukses të synimeve të këtij dokumenti.

Së fundi, Zyra e Komisionerit është e vetëdijshme se Plani i Integritetit 2022-2025, si i pari që institucioni miraton, do të pasohet nga plane të tjera, duke krijuar përvojën e duhur në procesin e hartimit dhe zbatimit të tyre duke i bërë këto dokumente të përshërshme institucionale. Ruajtja e integritetit institucional është një proces i vazhdueshëm dhe i monitorueshëm dhe kjo po realizohet nëpërmjet raportit të monitorimit të këtij plani.

Qasja vlerësuese

Raporti i monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit të Zyrës së Komisionerit, përmban një analizë të përgjithshme të kuadrit rregullator mbi aspekte e integritetit, performancës institucionale (për t'i rezistuar shkeljeve të integritetit) si dhe çështje të transparencës në luftën kundër korrupsionit.


Ky raport është hartuar në bazë të kontributit të 4 drejtorive, të një grupi të brendshëm pune dhe të koordinatorit të së drejtës së informimit, një funksion i përcaktuar në zbatim të ligjit për të drejtën e informimit, për të cilat ka pasur të parashikuar masa për vitin e parë të zbatimit 2023.

Plani i integritetit i Zyrës së Komisionerit është një dokument që paraqet standarde profesionale, duke parashikuar objektiva madhore dhe masat që duhen të zbatohen nga punonjësit e institucionit për të realizuar dhe përmbushur këtë dokument. Raporti i monitorimit të këtij dokumenti shërben si një mjet për të menaxhuar dhe vlerësuar riskun e integritetit.

Nëpërmjet urdhrit nr.67, datë 05.05.2023, Zyra e Komisionerit caktoi koordinatorin për monitorimin e Planit të Integritetit.

Masat dhe aktivitetet e parashikuara për zbatim për vitin 2023 dhe niveli i realizimit për secilin objektiv.

Në kontekstin e sektorit publik, integriteti konsiston në përmbushjen e detyrimeve të: transparencës, llogaridhënies, etikës, ndershmërisë, efektivitetit dhe efijencës në përmbushjen e detyrave dhe të ushtrimit të funksioneve rregullatore dhe administrative. Vendorsja e planit të integritetit dhe sigurimi i zbatimit të tij përbën një qasje që garanton masat antikorruption dhe një mundësi të shtuar të suksesit të zbatimit të tyre. Për zbatimin e planit të integritetit për vitet 2022 – 2025 janë përcaktuar 3 objektiva të cilat janë të ndara në 23 risqe. Nga monitorimi rezulton se në totalin prej **23** risqeve të evidentuara në Planin e Integritetit 2022-2025, për periudhën raportuese, janë marrë masa për realizimin plotësisht të **18** prej tyre, ndërkohe **5** masa janë ende në proces dhe nuk ka asnjë masë ende të porealizuar.



Ky raport monitorimi evidenton rritjen dhe forcimin e transparencës së institucionit në publikimin dhe plotësimin e kuadrit ligjor, konsultimin publik, raportet e performancës dhe ato të auditimit (të brendshëm dhe të jashtëm).

Objektivi I: Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe forcimi i kapaciteteve njerëzore në lidhje me etikën dhe integritetin.

Zyra e Komisionerit i ka kushtuar vëmendje të veçantë menaxhimit të burimeve njerëzore dhe forcimit të etikës së integritetit të punonjësve të institucionit. Ky objektivi përmban një numër prej 10 masash të planifikuara për t'u zbatuar nga njësitë e përfshira, të cilat i referohen specifikisht rishikimit të formularëve të vlerësimit dhe përfshirjen e detyrave shtesë në përshkrimet e punës, organizimin e trajnimeve të ndryshme me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (në vijim "ASPА") dhe Institucione të tjera sipas fushave të veprimtarisë, përfshirja e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik në rregulloren e brendshme të institucionit etj.

Për periudhën raportuese lidhur me masat e parashikuara për zbatim me qëllim përmbushjen e Objektivit 1, Zyra e Komisionerit ka pasur këtë progres:

- Risku dhe ngjarjet e mundshme: *"Përshkrimet e punës dhe formularët e vlerësimit të punës nuk reflektojnë plotësisht detyrat shtesë"*.
Për këtë risk janë rishikuar vlerësimet e punës dhe përshkrimet e detyrave shtesë sipas strukturës të miratuar me vendimin e Kuvendit nr. 24/2023 *"Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 86/2018 "Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimin e pagave të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale"*. Rishikimet e formularëve të punës janë në proces të vazhdueshëm nga ana e Zyrës së Komisionerit dhe kryhen çdo 6 muaj.
- Risku dhe ngjarjet e mundshme: *"Moskryerja e analizës së nevojave për trajnimet"*.
Gjatë vitit 2023, Zyra e Komisionerit ka bashkëpunuar vazhdimisht me ASPA, lidhur me trajnimet dhe vlerësimin e ndikimit të tyre tek punonjësit duke përcaktuar temat e nevojshme për trajnimin e stafit, të cilat janë bërë pjesë e temave të trajnimeve të organizuara nga ASPA.
- Risku dhe ngjarjet e mundshme: *"Procedurat standarde të veprimit për aksesin në dosjet e personelit mungojnë"*.
Për këtë masë janë hartuar dhe miratuar procedurat standarde të veprimit (PSV) lidhur me aksesin në dosjet e personelit e cila rregullohet nëpërmjet ligjit nr. 9887/2008 *"Për mbrojtjen e të dhënave personale"* dhe ligjit nr.152/2013 *"Për nëpunësin civil"*. Ky është një proces i vazhdueshëm për të cilin Zyra e Komisionerit vepron me rigorozitet.
- Risku dhe ngjarjet e mundshme: *"Kapacitete teknike të kufizuara lidhur me kuadrin rregullator të etikës dhe integritetit"*.
Nëpërmjet urdhrin nr. 109, datë 14.07.2022 u miratua *"Kodi i Etikës të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale"*. Me qëllim njohjen e stafit me Kodin e Etikës, Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Financës në bashkëpunim me ASPA dhe IDM (Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim) organizuan trajnime për etikën dhe integritetin.
- Risku dhe ngjarjet e mundshme: *"Procedurat standarde të veprimit nuk janë të hartuara për të gjitha proceset e punës sipas pozicioneve të punës në institucion"*.

Hartimi dhe miratimi i procedurave standarde të veprimit për ato pozicione pune që mungojnë, është në vijueshmëri nga ana e Zyrës së Komisionerit, duke qenë në proces evidentimi vendet e punës sipas vendimit të Kuvendit nr.24/2023 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 86/2018 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimin e pagave të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*.

- Risku dhe ngjarjet e mundshme: *“Njohuri teknike të kufizuara për konfliktin e interesit, pranimin dhe deklarimin e dhuratave, favoret dhe deklarimin e pasurisë”*.

Zyra e Komisionerit në mënyrë të vazhdueshme dhe në bashkëpunim me ASPA ka marrë pjesë në trajnime periodike për konfliktin e interesit, dhuratat, favoret dhe deklarimin e pasurisë.

- Risku dhe ngjarjet e mundshme: *“Mungesa e trajnimeve për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”*.

Janë organizuar trajnime në bashkëpunim me ILDKPKI, mbi sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. Duke marrë parasysh miratimin e strukturës së re të Zyrës së Komisionerit, këto trajnime do të vijojnë edhe për nëpunësit e rinj.

- Risku dhe ngjarjet e mundshme: *“Mungesa e një procedure standarde të veprimit për dorëzimin e detyrës në rastet e largimit nga puna”*.

Hartimi dhe miratimi i procedurave standarde të veprimit për dorëzimin e detyrës dhe largimin nga detyra është drejt finalizimit të një *“procedure standarde”* që do të ndiqet në zbatim të legjislacionit në fuqi mbi punësimin.

- Risku dhe ngjarjet e mundshme: *“Detyrat e koordinatorit të njoftimit dhe konsultimit publik nuk pasqyrohen në rregulloren e brendshme të institucionit”*.

Zyra e Komisionerit ka hartuar rregulloren e brendshme në të cilën ka përfshirë edhe rolin dhe pozicionin e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik.

- Risku dhe ngjarjet e mundshme: *“Njohuri të kufizuara të Koordinatorit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik për procesin e njoftimit dhe konsultimit publik”*.

Me Vendimin e Kuvendit nr.24/2023 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 86/2018 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimin e pagave të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*, pranë Zyrës së Komisionerit është ngritur një strukturë e posaçme, *“Sektori për të Dhënat e Hapura dhe Konsultimin Publik Sektori për të Dhënat e Hapura dhe Konsultimin Publik”* i cili ndër të tjera ka objekt të veprimtarisë: a) shqyrtimin e ankesave të qytetarëve dhe/ose grupeve të interesit, të cilët pretendojnë se u janë shkelur të drejtat e parashikuara në ligjin për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik, si dhe ligjin për njoftimin dhe konsultimin publik; b) kryerjen e hetimeve administrative dhe zhvillimin e seancave dëgjimore publike; c) hartimin e akteve administrative si vendime apo rekomandime në përfundim të procesit të hetimit administrativ; e) zhvillimin e aktiviteteve njohëse/trajtuese/ndërgjegjësuere me grupet e interesit për zbatimin e legjislacionit për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik. Paralelisht lidhur me këtë të strukturë, stafi përbërës është angazhuar në trajnime të vazhdueshme, pranë Ministrisë së Drejtësisë.

Në format tabelare dhe grafik për objektivin specifik, masat janë si më poshtë vijon:

<i>Objektivi I: Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe forcimi i kapaciteteve njerëzore në lidhje me etikën dhe integritetin (10 masa të parashikuara për vitin 2023)</i>	
Plotësisht të realizuara	8
Pjesërisht të realizuara	2
Të parealizuara	-



Objektivi II: Rritja e transparencës dhe mbrojtja e të dhënave personale.

Mbrojtja e të dhënave personale dhe transparenca janë dy elementët kryesor të veprimtarisë së Zyrës së Komisionerit. Ky objektivi përmban një numër prej 9 masash specifike të planifikuara për t’u zbatuar nga njësitë e përfshira. Qëllimi kryesor i këtij objektivi është forcimi i transparencës dhe ruajtjes së pavarësisë së Zyrës së Komisionerit, e cila intensifikoi hapat për përafrimin e legjislacionit kombëtar në fuqi nëpërmjet zbatimit të Projektit të Binjakëzimit “Mbështetje institucionit për përafrimin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale me *acquis-in* e Bashkimit Evropian”.

Për periudhën raportuese lidhur me masat e parashikuara për zbatim, në përmbushje të Objektivit II, Zyra e Komisionerit ka pasur këtë progres:

- Risku dhe ngjarjet e mundshme: “Mos përditësimi i kuadrit ligjor në fushën e të drejtës për informim”.
Zyra e Komisionerit ka përfunduar procedurën e hartimit të ndryshimeve ligjore për të drejtën e informimit. Kuvendi ka miratuar ligjin nr.78/2023 ‘Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119 datë 14.09.2014 “Për të drejtën e informimit”’.
- Risku dhe ngjarjet e mundshme: “Mos përditësimi i kuadrit ligjor në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale”.
Zyra e Komisionerit, si masë për përmbushjen e kësaj pike, ka përfunduar procedurën për hartimin e projektligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe akteve nënligjore. Nga ana e Zyrës së Komisionerit puna dhe kontributi i saj konsiderohet i përmbushur, duke

lënë në dorë të institucioneve përgjegjëse si Ministria e Drejtësisë dhe Kuvendi për të vijuar më tej me procesin, me qëllim miratimin e këtij projektligji.

- Risku dhe ngjarjet e mundshme: *“Njohuri teknike të kufizuara të stafit të punësuar rishtazi në institucion për Kodin e Procedurave Administrative”*

Janë organizuar trajnime të posaçme për stafin (duke përfshirë edhe nëpunësit e rinj) të Zyrës së Komisionerit, lidhur me njohuritë për Kodin e Procedurave Administrative, trajnime të cilat kryhen në mënyrë të vazhdueshme.

- Risqet dhe ngjarjet e mundshme *“Manuali i inspektimit nuk është i përditësuar”, “Mungesa e procedurave standarde të veprimit për administrimin e dosjeve të inspektimeve”, “Mungesa e procedurave standarde të veprimit për rastet e inspektimit”*. Në lidhje me këto risqe, sqarojmë se janë hartuar dhe miratuar procedura standarde të veprimit për administrimin e dosjeve të inspektimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes së të Dhënave Personale dhe Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit. Rishikimi dhe përditësimi i manualit të inspektimit është duke u rishikuar dhe përditësuar nga Zyra e Komisionerit në bashkëpunim me OSBE.

- Risku dhe ngjarjet e mundshme: *“Mungesa e trajnimeve të stafit për teknikën legjislative”*.

Zyra e Komisionerit ndjek në mënyrë të vazhdueshme trajnime të posaçme lidhur me teknikën legjislative, organizuar dhe zhvilluar nga Ministria e Drejtësisë.

- Risku dhe ngjarjet e mundshme *“Mungesa e trajnimeve për teknikat e inspektimit”*.

Janë organizuar trajnime të brendshme për teknikat e inspektimit lidhur me zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe legjislacionit për të drejtën e informimit, për institucione të ndryshme të Administratës Publike dhe subjektet private.

- Risku dhe ngjarjet e mundshme *“Mungesa e trajnimeve për rastet e kufizimeve të së drejtës për informim”*.

Zyra e Komisionerit ka organizuar trajnime të posaçme dhe periodike për rastet e kufizimeve të së drejtës për informim. Trajnime të stafit të Zyrës së Komisionerit lidhur me këtë temë do të organizohen edhe me Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, Ministrinë e Financave etj.

Në format tabelar dhe grafik për objektivin specifik, masat janë si mposhtë vijon:

<i>Objektivi II: Rritja e transparencës dhe mbrojtja e të dhënave personale (9 masa të parashikuara për vitin 2023)</i>	
Plotësisht të realizuara	6
Pjesërisht të realizuara	3
Të parealizuar	-



Objektivi III: Përmirësimi i sistemit të ruajtjes së dokumentacionit dhe dixhitalizimi i arkivës.


Një ndër objektivat kryesorë të Zyrës së Komisionerit mbetet ruajtja e dokumentacionit dhe dixhitalizimi i arkivës së institucionit, duke qenë se informacionet që administrohen janë me karakter publik, personal dhe informacion të klasifikuar si informacion shtetëror. Çdo dokument i depozituar pranë institucionit ruhet në format të printuar në letër dhe në format elektronik.

Për periudhën raportuese lidhur me masat e parashikuara për zbatim me qëllim përmbushjen e Objektivit III, Zyra e Komisionerit ka pasur këtë progres:

- Risqet dhe ngjarjet e mundshme: *“Mosfiksionimi i sistemit digjital të protokollit”* dhe *“Arkiva digjitale nuk është tërësisht funksionale”*.
Për këtë Zyra e Komisionerit ka realizuar me sukses ndërtimin, funksionimin e një sistemi të ri digjital të protokoll- arkivës duke përditësuar pajisjet, softwer-in si dhe ka planifikuar mirëmbajtjen e këtij sistemi për një periudhë 3 vjeçare.
- Risku dhe ngjarjet e mundshme *“Mungesa e procedurave standarde të veprimit për arkivimin e dokumentacionit”*.
Lidhur me këtë masë Zyra e Komisionerit ka hartuar PSV jo vetëm për arkivën, por edhe për procedura të tjera.
- Risku dhe ngjarjet e mundshme *“Mungesa e sinjalistikës së nevojshme në Zyrën e Protokollit”*
Zyra e Komisionerit ka marrë të gjitha masat për vendosjen e sinjalistikës së nevojshme orientuese për zyrën e protokollit, si dhe është realizuar ndarja e zyrës së protokollit nga pjesa tjetër e personelit.

Në format tabelar dhe grafik për objektivin specifik, masat janë si mposhtë vijon:

<i>Objektivi III: Përmirësimi i sistemit të ruajtjes së dokumentacionit dhe digitalizimi i arkivës (4 masa të parashikuara për vitin 2023)</i>	
Plotësisht të realizuara	4
Pjesërisht të realizuara	-
Të parealizuara	-



Konkluzione dhe Rekomandime

Ky raport monitorimi është kryer në përputhje me metodologjinë e monitorimit të instrumentit të Planit të integritetit 2022-2025. Viti 2023, ishte viti i parë i zbatimit të këtij Plani Integriteti në Zyrën e Komisionerit, vit gjatë të cilit u hasën edhe disa vështirësi që patën ndikimin e tyre mbi ecurinë e zbatimit të tij, sipas parashikimeve të bëra dhe afateve konkrete. Për hartimin e Planit të Integritetit të Zyrës së Komisionerit, u angazhua një grup pune me 5 punonjës, si dhe ekspertë të IDM.

Çdo strukturë përbërëse e Zyrës së Komisionerit, ka dhënë kontributin përkatës për realizimin e këtij Plani Integriteti. Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi, të gjetjeve që ky dokument na ofron, dhe që janë realizuar, rezulton se:

- Zyra e Komisionerit ka vijuar me zbatimin e planit të integritetit, i cili është parashikuar për një afat kohor gjatë viteve 2022 - 2023;
- Zyra e Komisionerit, ka realizuar me sukses përmbylljen e paketave ligjore lidhur me projektligjin për të drejtën e informimit dhe projektligjin për mbrojtjen e të dhënave personale;
- Në mënyrë të vazhdueshme Zyra e Komisionerit në bashkëpunim me ASPA është pjesë në trajnime të ndryshme, sipas tematikave të nevojshme;

Është përditësuar rregullorja e brendshme e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në funksion të miratimit të Vendimit të Kuvendit nr.24/2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 86/2018 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimin e pagave të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

- Është garantuar transparenca e plotë dhe ofrimi i informacioneve mbi aktivitetin e institucionit për publikun e gjerë nëpërmjet faqes së internetit www.idp.al.

Megjithatë, në vijim rekomandohet që strukturat përgjegjëse të institucionit, nën koordinimin e personit përgjegjës për monitorimin e Planit të Integritetit të Zyrës së Komisionerit, të marrin masa për ndjekjen dhe përbushjen e objektivave në proces me qëllim shmangien e risqeve të evidentuara.

Gjithashtu, pas një analize gjithpërfshirëse të sa më sipër, vlerësohet e nevojshme marrja e masave për nisjen e procesit të hartimit të Planit të ri të Integritetit të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.